



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM

Nr.150, datë 24.07.2024

PËR
“CAKTIM TË PËRKOHSHËM”

Bazuar në nenin 149/a të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenin 59 pika 1 dhe 4, të ligjit Nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, nenet 164 pika 8, 166 pika 2, 189 pika 1, germa “a” të ligjit Nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” i ndryshuar, Rregulloren “Për caktimin e përkohshëm të prokurorëve” e ndryshuar, si dhe relacionin shpjegues të për gatitur nga anëtari Relator, Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

V E N D O S I:


1. Zoti Gëzim Spahiu, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër, të caktohet përkohësisht prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, duke plotësuar vakancën e krijuar nga vendimi i KPK-së që i takon subjektit të rivlerësimit Neritan Hoxha.
2. Zoti Gëzim Spahiu do të ushtrojë funksionin e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, nga data 29.07.2024 - 28.10.2024.
3. Të njoftohen për këtë vendim prokurori Gëzim Spahiu, Prokurori i Përgjithshëm, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër dhe Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare web të Këshillit.
5. U shpall në Tiranë, sot më 24.07.2024.

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË



ANËTAR
Zeqir Hoda

ANËTAR
Arta Mandro



ANËTAR
Vatë Staka



ANËTAR
Ledina Riza



ANËTAR
Olger Eminaj
(kundër)



ANËTAR
Moisi Duda

